



Raport Mujor Korrik 2023

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 2,284,819
Cmimi i kuotës	95.8414
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Kthimi vjetor nga investimi në 31 Korrik 2023	+2.40%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.59% per vitin 2022 ne 31.12.2022
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetë butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet. Obligacionet janë të investuara në titujt të Qeverisë Shqiptare (38.3%), obligacione të korporatave dhe fonde investimi me fokus në obligacione (20.2%).

Pjesa e aksioneve (32.6%) është e investuar në tregje të zhvilluara: SHBA 18.8%; Zona Euro 8.4%, Britani e Madhe 2.4% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është rritur në 9.8% në fund të muajit Korrik.

Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri pozitive mujore prej **+1.08%** gjatë muajit korrik.

Investimet në obligacione dhe aksione kanë regjistruar performancë mujore pozitive. Pritshmerite e tregut lidhur me faktin që normat e interesit të obligacioneve janë afër nivelit të pikut dhe së shpejti bankat qendrore mund t'i japin fund ciklit të rritjes së normave të interesit, kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e mire të tregjeve të kapitalit. Eurobondet e Qeverisë shqiptare patën ecuri pozitive mujore, duke fituar 70 -100 pike përqindje në çmim gjatë muajit korrik. Aksionet në SHBA dhe Evropë vazhduan të rriteshin dhe investimet në aksione të fondit Miks ishin ndër performuesit më të mirë mujorë.

Kthimi neto vjetor i fondit Miks është +2.40% më 31 korrik 2023.

Ecuria e performancës së Fondit Raiffeisen Miks



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfutur nje

kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Korrik

Norma vjetore e inflacionit në SHBA ra nga 4% në 3% në Qershor dhe norma bazë e inflacionit u ngadalësua nga 5.3% në 4.8%, që është një shenjë e mirë se politika monetare shtrënguese po jep efektet e dëshiruara në inflacion.

Nga ana tjetër, ekonomia amerikane po konfirmon një qëndrueshmëri të mirë, duke shënuar një rritje ekonomike mbresëlënëse prej 2.5% p.a. gjatë tremujorit të dytë dhe shifra solide ne tregun e punës.

Presionet inflacioniste në eurozonë vijuan të zbuten dhe norma vjetore e inflacionit pesoi renie nga 6.1% në 5.5% në qershor, ndërsa inflacioni bazë u rrit lehtë në 5.5%.

Të dyja bankat qendrore (Rezerva Federale në SHBA dhe Banka Qendrore Europiane në BE) bënë rritjen e radhës të normës së interesit prej 0.25% në muajin Korrik, duke çuar normën e fondit të Fed në 5.25% -5.5% dhe normën bazë në Eurozonë në 4.25%.

Muaji korrik u karakterizua me rënie të yield-eve në tregun e obligacioneve. Ecuria pozitive u shkaktua nga renia e ndjeshme e inflacionit në SHBA, gjë që gjithashtu ka ushqyer shpresat se edhe në zonën e euros Banka Qendrore mund t'i japë fund së shpejti rritjes së normave të interesit.

Pavarësisht një fillimi të ngadaltë për indekset dhe bursat kryesore gjate korrikut, rezultatet pozitive te tremujorit te dyte shkaktuan rritje të aksioneve.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dh eforcashitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar t ëkuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyravetë Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.